

URDHËR
Nr. 726, datë 26.10.2015

**PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË DOKUMENTEVE STANDARDE NË
PËRPUTHJE ME DISPOZITAT LIGJORE PËR TREGTINË NDËRKOMBËTARE
TË LLOJEVE TË RREZIKUARA TË FAUNËS DHE TË FLORËS SË EGËR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të shkronjës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe në zbatim të nenit 24, të ligjit nr. 9867, datë 31.1.2008, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formatit të:
 - a) kërkesës për regjistrim, si dhe të kërkesës për t’u pajisur me leje sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij urdhri;
 - b) lejes për import dhe/ose për eksport, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, sipas shtojcave 2 dhe 2/1 bashkëlidhur këtij urdhri;
 - c) regjistrin ku hidhen të dhënat nga personat fizikë e juridikë, të pajisur me leje, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij urdhri;
 - d) kërkesës për të dhënat, që raportojnë personat e regjistruar e të pajisur me leje, sipas shtojcës 4 bashkëlidhur këtij urdhër;
 - e) regjistrin të ekspertëve të certifikuar, sipas shtojcës 5 bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura që të organizojë punën në përputhje me detyrimet që vijnë për aplikimin e këtyre formateve për zbatimin e ligjit, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër”, të ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka